



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:204227

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05538884

KPPP.nr. 1539/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. "Hazir Shala", nr. 4, kundër debitorit "Timi Invest", me numër unik identifikues 70624826 dhe seli në Prishtinë, rr. "Shkupi". A-1-46, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 591/2023 të datës 16.08.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 03.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "Timi Invest", me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 591/2023 i datës 16.08.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" Sh.A., me datë 16.08.2023 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 591/2023 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Ekstraktit nga librat afarist me shifrën K060263, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar për shërbimet e furnizimit me ujë, t'ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 573.71 EUR, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit me arsyetim se propozimi për përbarim është dërguar gabimisht në zyret e Timi Invest, pasi që ndaj kreditorit nuk kanë asnjë obligim sepse të gjitha obligimet i kanë kryer me rregull. Ka shtuar se shifra 060263 është shifër e një lokal tjetër që nuk e ka në posedim që nga data 01.11.2019.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, duke sqaruar se kreditori ka furnizuar me ujë lokalín apo objektin në pronësi të debitorit, ashtu që për kreditorin nuk është e rëndësishme se si kanë qenë të rregulluara raportet në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit në kuptim të përmbushjes së detyrimeve ndaj kreditorit, mirëpo është e rëndësishme se shfrytëzuesi i objektit nuk i ka paguar dhe ato duhet t'i përmbushë pronari, gjegjësisht debitori. Ka shtuar se ekstrakti nga librat afarist ka cilësinë e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29, par. 1, pika 2 të LPP-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se ekstrakti nga librat afarist me shifër K060263 mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së, ngase në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që nga ekstrakti afarist, rezulton se borxhi prej 573.71 EUR është krijuar për periudhën kohore 01.01.2013 e deri më datë 16.08.2023, ndërsa në përmbajtjen e ekstraktit, janë të listuara faturat vetëm nga data 31.12.2022 e tutje, ashtu vlera e borxhit prej 458.79 EUR e paraqitur si saldo, nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar dhe a është njoftuar debitori lidhur me këtë detyrim.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1539/23, datë 03.04.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.